

# PËRMIRËSIMI I ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS NË KOSOVË

NXITJA E ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS  
DHE DIVERSITETIT NË SHKOLLAT E  
KOSOVËS

---

Hulumtim i Politikave

Korrik, 2018



## Mirënjohje

Anëtarët e Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të japin informacione dhe të dhëna të paçmueshme për këtë raport.

## OJQ-ja udhëheqëse për publikimin e Raportit

**ECMI Kosova** ([www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org))

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

**Rr. Nëna Terezë Nr. 20, Apt. 5,  
10000 Prishtinë – Kosovë,  
Tel. +381 (0) 38 224 473**

**Rr. Kralja Petra 183 a  
38220 Mitrovicë e Veriut – Kosovë**

## Equal Rights for All Coalition

Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC) bashkon shtatë (7) OJQ-të që punojnë në fushën e **sundimit të ligjit** dhe **të drejtave themelore** në bashkëpunim të ngushtë me **nëntëmbëdhjetë (19) OJQ të angazhuara kryesisht në nivel lokal**, me një fokus të veçantë në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara (GRM-ve). Fokus specifik i projektit janë grupet si në vijim: **të gjitha komunitetet jo-shumicë** në Kosovë, **gratë, rinia**, dhe **pjesëtarët e komunitetit LGBT**. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarët e ERAC janë organizatat e mëposhtme:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë - Lidere e Koalicionit të drejtat e barabarta për të gjithë;
- Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore;
- Qendra për Barazi dhe Liri të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut;
- Glocal Kosova;
- Centre Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional.

## Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosova dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## E drejta autoriale

© Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), korrik 2018. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC-ut.



# PËRMIRËSIMI I ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS NË KOSOVË

NXITJA E ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS  
DHE DIVERSITETIT NË SHKOLLAT E  
KOSOVËS

---

Hulumtim i Politikave





<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>7</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>8</b>
<b>QËLLIMIDHEMETODOLOGJIA</b> .....	<b>10</b>
<b>INFORMATA GJENERALE</b> .....	<b>11</b>
Gjendja aktuale.....	11
Korniza Legjislative.....	13
Strategjitë e fundit qeveritare.....	14
Korniza Institucionale.....	15
<b>ANALIZA E ZBATIMIT</b> .....	<b>17</b>
Plani i veprimit në terren.....	17
Arritjet.....	19
Sfidat në terren.....	21
<b>KONKLUZIONE</b> .....	<b>22</b>
<b>REKOMANDIMET</b> .....	<b>23</b>
Rekomandime për shkollat.....	23
Rekomandime për DKA-të.....	23
Rekomandime për MASHT-in.....	24
<b>REFERENCAT</b> .....	<b>25</b>

## **LISTA E SHKURTESAVE**

<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>QPS</b>	Qendra për Punë Sociale
<b>DSMS</b>	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
<b>ECMI Kosova</b>	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Arsimit
<b>ERAC</b>	Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë
<b>SPH</b>	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
<b>QMF</b>	Qendra e Mjekësisë Familjare
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>DKKRS</b>	Drejtoria Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport
<b>ZKKK</b>	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
<b>MiM</b>	Memorandumi i Mirëkuptimit
<b>FJS</b>	Fëmijët jashtë shkollës
<b>EPRBM</b>	Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit
<b>OZQ4</b>	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 4
<b>ISU</b>	Instituti i Statistikave të UNESCO-s
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>UNESCO</b>	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara
<b>UNICEF</b>	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencave për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara

Ndër të drejtat themelore të fëmijëve, qasja në arsim është e garantuar në mënyrë solide nga marrëveshjet ndërkombëtare, mbi të gjitha Konventa për të Drejtat e Fëmijës (e vitit 1989). Qasja e barabartë në sistemin arsimor konsiderohet të jetë hapi i parë drejt përfshirjes së plotë sociale në një vend demokratik. Fenomeni i braktisjes ose largimi i hershëm nga shkolla pengon këtë proces social dhe pengon qasjen e lirë në tregun e punës.

Sipas statistikave<sup>1</sup>, megjithëse shkalla e braktisjes së shkollës është ulur ndjeshëm në vitet e fundit nga 0,48% në 2011 në 0,12% në vitin 2014, rreziku i braktisjes së shkollës ende paraqet një sfidë themelore në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021. Viteve të fundit shkollorë janë identifikuar dhe regjistruar rreth 1'061 raste të braktisjes së shkollimit të obligueshëm prej tyre 483 (45,5%) janë vajza dhe 578 (54,5%) janë djem. Është përgjithësisht e pranuar dhe njohur që marrëdhënia midis arsimit gjithëpërfshirës dhe përfshirjes sociale ndikon në ecurinë ekonomike dhe sociale të një vendi. Nivelet e punësimit dhe kriminalitetit varen në mënyrë rigorozë nga niveli i arsimit dhe aftësive profesionale të popullatës. Kështu, një strategji gjithëpërfshirëse arsimore paraqet prioritet në një perspektivë afatgjatë të punësimit të plotë dhe kohezionit social. Shkalla e papunësisë në Kosovë është shumë e lartë në krahasim me standardet evropiane, duke treguar një çarje në qasjen në arsimin e rregullt.

Në përputhje me misionin për avokimin e të drejtave të njeriut për grupet e cenueshme dhe të marginalizuara shoqërore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në partneritet me shumë organizata të jashtme si ECMI Kosova, UNICEF-i, Save the Children, Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), Idea Partnership, etj, i jep prioritet të lartë çështjes së arsimit gjithëpërfshirës në fushën e arsimit. Hapi i parë ka të bëjë me identifikimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e detyrueshëm. Kategoritë e identifikuar nga MASHT<sup>2</sup> janë fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e riadhesuar dhe ata të kthyer, fëmijët me probleme socio-ekonomike, fëmijët që u përkasin tre komuniteteve rom/ashkali/egjiptian, fëmijët që punojnë për të ardhurat e familjes, vajzat shtatzëna ose të martuara dhe fëmijët që janë trafikuar ose abuzuar seksualisht.

Koalicioni ERAC përmes këtij studimi merr në konsideratë situatën aktuale duke ofruar një analizë të thellë të strategjisë tashmë të miratuar<sup>3</sup> për të trajtuar çështjen e braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë, sipas Udhëzimit Administrativ të ndryshuar kohët e fundit (UA 18/2018). Për hir të saktësisë, studimi mbulon vetëm sistemin arsimor të Kosovës të organizuar dhe mbikëqyrur nga MASHT-i dhe nuk merr në konsideratë shkallën e pjesëmarrjes në sistemin arsimor të zhvilluar në gjuhën serbe dhe të mbështetur nga Ministria e arsimit e Serbisë. Për më tepër, në këtë studim do të shqyrtohet një përkrahim i hollësishëm i veprimeve në terren të kryera nga Ekipet për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit (EPRBM-të) për zbatimin e Sistemit të paralajmërimit të hershëm (SPH-së). Rekomandimet përfundimtare synojnë të rrisin zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të EPRBM-ve shkollorë dhe komunale për gjetjen një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe zbatimin e planeve të veprimit.

<sup>1</sup> Raporti i Vlerësimit të PSAK 2011-2015.

<sup>2</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2016/2017. MASHT dhe ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës). Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim, 2017. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2016-17-shqip.pdf>

<sup>3</sup> Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë. Manual për Ekipet për parandalimin dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e detyrueshëm. Qeveria e Kosovës. Dhjetor 2014. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/manual-for-school-prevention-and-response-1.pdf>

Arsimi është i garantuar me instrumentin e parë ndërkombëtar, ligjërish të detyrueshëm në Kosovë, që mbron të drejtat e fëmijëve, që është Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989). Ky dokument hap rrugën për nismat mbarëbotërore që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin mbi konceptet themelore siç është interesi më i mirë i fëmijës dhe obligimet e palëve të interesuara për ta siguruar atë. Para këtij dokumenti, Konventa e OKB kundër diskriminimit në arsim<sup>4</sup>(1960) për herë të parë, në formë të drejtpërdrejtë, e ka trajtuar çështjen e arsimit gjithëpërfshirës si një prioritet. Deklaratat më të fundit, si Deklarata e Salamankës e UNESCO-s (1994) dhe Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006), aktualisht paraqesin një bazë të fortë ligjore për veprim. Ne takimin e fundit mbi çështjen e Arsimit, të mbajtur në Incheon në maj të vitit 2015, është hartuar marrëveshja e fundit në përputhje me të drejtat universale të arsimit për të gjithë: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 4 (OZQ4) dhe Korniza Arsimore 2030 për Veprim. Deklarata e Incheon-it pretendojnë detyrat e palëve të përfshira për të "Siguruar arsim gjithëpërfshirës të cilësisë së barabartë dhe për të promovuar mundësitë e të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë"<sup>5</sup>. Parimet e dokumentuara në këtë studim janë (1) arsimi/edukimi si një e drejtë themelore, e cila praktikisht garanton të paktën dymbëdhjetë vjet të arsimit pa pagesë dhe të detyrueshëm në secilin vend; (2) koncepti i arsimit si një e mirë publike dhe një "përpyetje e përbashkët shoqërore"<sup>6</sup>; (3) ndërlidhjen e koklavitur me barazinë gjinore. Qëllimi përfundimtar i angazhimeve ndërkombëtare është trajtimi i të gjitha formave të pabarazive dhe marginalizimit drejt një përfshirjeje të plotë në sistemin arsimor. Objektivat kryesore të OZQ4 kërkojnë një përfshirje cilësore në arsim në të gjitha nivelet: në shkollën fillore dhe në shkollën e mesme, edukimin dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme, arsimin e lartë dhe universitar, arsimin teknik dhe profesional, rritjen e shkathtësisë.

Arsimi gjithëpërfshirës është i lidhur ngushtë me përfshirjen sociale, në një shoqëri ku dallimet kontribuojnë në një shumëllojshmëri të domosdoshme të shtresave shoqërore. Një sistem gjithëpërfshirës i bazuar në vlerat demokratike, tolerancë dhe respekt nxit zhvillimin ekonomik dhe harmoninë shoqërore. Procesi i kundërt i përkufizuar si mospërfshirje shoqërore mund të ndodhë në fazat e hershme të jetës (Agoni-Destani, Hoxha, Kelmendi, 2015). Prandaj, arsimi gjithëpërfshirës luan një rol të rëndësishëm dhe kontribuon në mekanizmin më të gjerë të përfshirjes sociale, siç, përgjithësisht—kërkohet në një shoqëri demokratike. Prandaj ky studim ka për qëllim të fokusohet tek fëmijët që u përkasin grupeve shoqërore të marginalizuara dhe të cenushme në Kosovë. Sipas Robo (2014), një arsim gjithëpërfshirës cilësorë gjeneron një shoqëri më përfshirëse. Për shembull, fëmijët më të pa-favorizuar dhe të cenushtëm përfitojnë nga programe të veçanta të kujdesit dhe edukimit që fillojnë në shkolla. Duke marrë parasysh lidhjen midis braktisjes së hershme nga arsimi formal me mundësitë e punësimit dhe standardet e jetesës, arsimi paraqet parakusht themelor për një rritje ekonomike të favorshme; kapacitetet dhe kualifikimi i kapitalit njerëzor në procesin e prodhimit varen shumë nga cilësia e sistemit

<sup>4</sup> Konventa kundër Diskriminimit në Arsim 1960, Neni 1: "Për qëllimet e kësaj Konvente, termi" diskriminim "përfshin çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë që, duke u bazuar në racën, ngjyrën, seksin, gjuhën, fenë, mendimin, origjinën kombëtare ose sociale, gjendjen ekonomike, ka si qëllim shfuqizimin ose dëmtimin e barazisë së trajtimit në arsim dhe në veçanti:

- (a) Të privojë ndonjë person ose grup personash nga qasja në arsim të çfarëdo lloji ose të çdo niveli;
- (b) Kufizimin e çdo personi ose grupi personash në arsim të një standardi inferior;
- (c) Në varësi të dispozitave të nenit 2 të kësaj Konvente, të krijimit ose mbajtjes së sistemeve ose institucioneve të veçanta arsimore për personat ose grupet e personave; ose
- (d) T'i shkaktojë ndonjë personi apo grupi personash kushte të cilat nuk janë në përputhje me dinjitetin e njeriut.

[http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL\\_ID=12949&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=12949&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

<sup>5</sup> Deklarata e Incheon-it, maj 2015. <https://en.unesco.org/world-education-forum-2015/incheon-declaration>

<sup>6</sup> Korniza për veprim, OZS4 – Arsimi 2030, faqe 28. <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002456/245656E.pdf>



arsimor. Ndryshimet strukturore në Ballkanin perëndimor kanë ndikuar ashpër apo shumë rëndë të drejtën e qasjes në arsim për shumë grupe të marginalizuara. Shkalla e papunësisë në Kosovë është shumë e lartë në krahasim me standardet evropiane, duke treguar një mospërputhje të qartë në qasjen në arsimin formal<sup>7</sup>. Sipas Raportit të Vlerësimit të Planit Strategjik 2011-2016<sup>8</sup>, Norma e regjistrimit bruto (të përgjithshëm) në arsimin parauniversitar në Kosovë, përgjithësisht—është rritur, e vendosur pak më poshtë se standardet evropiane. Për shembull, në arsimin e mesëm të lartë nga 82% në vitin 2009 në 97% në vitin 2014.

Duke pasur parasysh këtë, vlerësimi i arsimit është një tregues thelbësor për një studim gjithëpërfshirës të kushteve të fëmijërisë në një vend të caktuar. Megjithatë, pasqyra socio-ekonomike e Kosovës është ende shumë e larmishme në të gjithë rajonin - mbi të gjitha, hendeku midis zonave urbane/rurale - dhe komunave. Përfshirja e fëmijëve në sistemin arsimor paraqet një tregues kyç sa i përket vlerësimit të zhvillimit të hershëm të fëmijërisë. Në përputhje me misionin për avokimin e të drejtave të njeriut për grupet sociale të marginalizuara dhe të pambrojtura, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në partneritet me Fondin e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara (UNICEF) dhe Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova) ndjekin logjikën e një arsimit gjithëpërfshirës në fushën e arsimit. Hapi i parë ishte vendosja e një sistemi për identifikimin e hershëm të fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe rritjen e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimit të opinionit mbi këtë çështje. Kategoritë e identifikuara nga MASHT janë fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e riatdhesuar dhe të kthyer, fëmijët me probleme socio-ekonomike, fëmijët që u përkasin tre komuniteteve rom/ashkali/egjiptian, fëmijët që punojnë për të ardhurat e familjes, vajzat shtatzëna ose të martuara dhe fëmijët që janë trafikuar ose abuzuar seksualisht.

Ky hulumtim synon të vlerësojë situatën aktuale dhe të shqyrtojë veprimet e ndërmarra deri më tani në trajtimin e çështjes: (1) të verifikojë apo kontrollojë avancimin e rezultateve të deritanishme, (2) të adresojë pengesat praktike të hasura nga ekspertët në terren për sa i përket funksionalizimit të EPRBM-ve<sup>9</sup>, (3) të ofrojë rekomandime të politikave për përmirësimin në të ardhmen. Përcaktimi i mospërputhjeve faktike midis direktivave qendrore dhe zbatimit të tyre në terren do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve ekzistuese dhe në identifikimin e ndërlikimeve për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme në praktikë. Ky studim do të mbështetet jo vetëm nga kërkimet e burimeve ekzistuese dhe/apo kërkimeve dhe studimeve paraprake, por edhe në të dhënat e mbledhura nga prania e gjatë dhe pothuajse e përhershme e ekspertëve të ECMI Kosovë përmes një bashkëpunimi të drejtpërdrejtë me EPRBM-të dhe palët e tjera përkatëse në nivelin lokal dhe atë qendror. Për përcaktimin e një plani të përgjithshëm zhvillimor, do të diskutohen arritjet e deritanishme në miratimin formal të procedurave të përbashkëta. Megjithatë, më shumë hapësirë do të lihet për të paraqitur nivelin e efektivitetit dhe të arriturave reale, pengesave dhe rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes në fazat e ardhshme. Para se të futemi në hollësi të veprimeve të ndërmarra në terren, është e nevojshme të përvijohen udhëzimet, vendimet dhe strategjitë aktuale qeveritare të nxjerra me qëllim të trajtimit të kësaj problematike.

7 Raporti i Vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2011-2016. MASHT, 2015. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-eng-web.pdf>

8 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2016-17.pdf>

9 Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit (EPRBM-të) në arsimin e detyrueshëm, të themeluara ma Udhëzimin administrativ 19/2012 së fundi të ndryshuar në UA 08/2018.

Duhet të jepet një sqarim për gjendjen aktuale të sistemit arsimor të Kosovës. Në Kosovë ekzistojnë dy sisteme paralele të arsimit: njëri prej tyre administrohet nga Qeveria e Kosovës, më konkretisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), e cila ofron arsim në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake. Dhe tjetri sponsorizohet dhe kontrollohet nga Republika e Serbisë respektivisht Ministria e Arsimit e Serbisë dhe ofron arsimim në gjuhën serbe. Në këtë studim trajtohet vetëm sistemi arsimor i administruar dhe mbikëqyrur nga MASHT-i. Për një analizë gjithëpërfshirëse të sistemit paralel në arsimin në gjuhën serbe, ju lutemi referojuni një botimi të ECMI Kosova për Arsimin në gjuhën serbe në Kosovë (2018)<sup>10</sup>. Veç treguesve, janë diskutuar dhe trajtuar edhe çështja e braktisjes dhe arritjeve arsimore si një indeks themelor cilësor i arsimit.

Seksioni i parë i kësaj analize i kushtohet bazës legislative që garanton gjithëpërfshirje, të pasuar nga shqyrtimi i udhëzimeve/vendimeve aktuale të nxjerra për të adresuar problemin dhe përfundimisht një përshkrimi i mjeteve dhe mekanizmave institucionalë të emëruar për veprim ad-hoc. Pjesa e fundit ofron një set rekomandimesh të ngritura nga vlerësimi i pengesave dhe sfidave në terren. Qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë nivelin e progresit të deritanishëm në trajtimin e këtij mjerimi shoqëror dhe arsimor, kështu që rekomandimet duhet të konsiderohen si sugjerime për përmirësimin e tyre në të ardhmen.

## **QËLLIMI DHE METODOLOGJIA**

Ky hulumtim synon të vlerësojë situatën aktuale dhe të shqyrtojë veprimet e ndërmarra deri më tani në trajtimin e çështjes: (1) të mas dhe verifikojë avancimin e rezultateve deri më tani, (2) të adresojë pengesat praktike të hasura nga ekspertët në terren sa i përket funksionalizimit të EPRBM-ve, (3) të ofrojë rekomandime të politikave për përmirësimin e situatës në të ardhmen. Përcaktimi i mospërputhjeve faktike midis udhëzimeve/vendimeve të nivelit qendror dhe zbatimit në terren do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve ekzistuese dhe në identifikimin e ndërlikimeve në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme në praktikë. Ky studim do të mbështetet jo vetëm në burimet e të dhënave në dispozicion dhe kërkimeve paraprake, por edhe në të dhënat e mbledhura nga prania shumëvjeçare në terren e ekspertëve të ECMI Kosovë përmes një bashkëpunimi të drejtpërdrejtë me EPRBM-të shkollore dhe komunale dhe palët e interesit në të dyja nivelet. Për një përcaktim të përgjithshëm të planit zhvillimor, studimi do të shqyrtojë arritjet e deritanishme në miratimin formal të procedurave të përbashkëta. Por më shumë hapësirë do të lihet për të paraqitur nivelin të arriturave reale, pengesave dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës në fazat e ardhshme. Para se të shtjellohen hollësitë e veprimit në terren, është e nevojshme të përvijohen direktivat dhe strategjitë aktuale qeveritare të nxjerra me qëllim të trajtimit të problemit.

Seksioni i parë i kësaj analize i kushtohet bazës legislative që garanton gjithëpërfshirje, të pasuar nga shqyrtimi i dokumenteve aktuale të nivelit qendror të nxjerra për të adresuar problemin dhe së fundi përshkrimi të detyrës së mekanizmave institucionalë të emëruar për veprim ad-hoc. Seksioni i fundit do të merret me rekomandimet që kanë dalë nga vlerësimi i pengesave dhe sfidave. Qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë nivelin e progresit të arritur deri më tani në trajtimin e kësaj anomalie shoqërore dhe arsimore, kështu që rekomandimet duhet të shihen si sugjerime për përmirësimin e situatës në të ardhshmen.

<sup>10</sup> Publikimi i ECMI Kosovës mbi arsimin në gjuhën serbe në Kosovë.

### Gjendja aktuale

Sipas Raportit Vjetor Statistikor 2016/2017<sup>11</sup> të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, numri i përgjithshëm i nxënësve që ndjekin mësimin e detyrueshëm në Kosovë është vlerësuar të jetë rreth 250'931 nxënës, duke përjashtuar institucionet parashkollore dhe ato të arsimit të lartë. Ndër treguesit e sugjeruar në Kornizën e Treguesve për Arsimin në Kosovë<sup>12</sup> (2017), Qasja dhe pjesëmarrja në arsim janë të lidhura me një karakterizim gjithëpërfshirës të arsimit dhe rrjedhimisht, thelbësore për vlerësimin e situatës aktuale në Kosovë. Ky makro tregues përfshin faktorë të posaçëm që kontribuojnë në vlerësimin e sistemit arsimor: numrat e të regjistruarve, fëmijët jashtë shkollës ose ata që nuk ndjekin mësimin e detyrueshëm, shkalla apo nivelin e arsimit, fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe/ose të mësuarit/nxënit. Prandaj, në lidhje me treguesit e paraqitur në Kornizën e sipërpërmendur, Raporti Vjetor Statistikor mbi Treguesit e Arsimit të vitit 2016/2017 paraqet një pamje të përgjithshme të progresit arsimor në vend. Duke u përqendruar në treguesin e Qasjes dhe Pjesëmarrjes, performanca arsimore e Kosovës vlerësohet të jetë shumë e ulët krahasuar me vendet e tjera evropiane.

Në vlerësimin e shkallës së qasjes dhe pjesëmarrjes në shkollë në bazë të niveleve shkollore, megjithëse situata është përmirësuar lehtë (+ 1,53% për shkollën fillore, + 2,65% për shkollën e mesme), rezultatet e mbledhura janë ende jo-inkurajuese. Për sa i përket shkollave fillore, Kosova ka përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes (96,2%) në renditje vetëm pas Maqedonisë. Krahasimi me vlerën më të lartë të pjesëmarrjes në shkollat fillore (Lituania me 103,4%) tregon për një nevojë urgjente për të rritur qasjen dhe pjesëmarrjen e barabartë në arsimin në Kosovë. Gjendja është më e mirë në shkollat e mesme: përqindja mesatare sillet rreth 93.3%, e cila megjithëse është më e lartë se në shumë vende të tjera të Ballkanit, duhet të konsiderohet ende shumë e ulët nëse i referohemi standardeve evropiane. Në të vërtetë, duke analizuar vlerën e përgjithshme të nivelit të pjesëmarrjes në shkollat e detyrueshme në Kosovë, rezultatet e paraqitura nga Raporti i fundit statistikor dëshmojnë një rënie të pjesëmarrjes në arsim (-0,4%) në krahasim me vitin paraprak. Vlera është ndër më të vogla në Evropë, e dyta nga fundit, Bullgaria. Norma e BE-së vlerësohet të jetë rreth 103,5%, e cila në krahasim me normën aktuale kosovare (94,8%), dëshmon se kjo e fundit është pa asnjë nën mesatare.

Megjithatë, qëllimi i këtij hulumtimi është trajtimi i një çështjeje specifike, pra vlerësimi i strategjisë së miratuar për të reduktuar numrin e fëmijëve jashtë shkollës në Kosovë. Raporti Vjetor Statistikor përmes një llogaritjeje komplekse të të dhënave, ka marrë një përqindje të fëmijëve jashtë shkollës prej klasës së 1-rë deri në të 9-të, rreth 5,2% (5,1% femra, 5,3% meshkuj). Normat e braktisjes nuk janë inkurajuese: në shkollën fillore shkalla e braktisjes është 0,1%, në shkollën e mesme të ulët 0,05%, ndërsa në shkollën e mesme vlerësohet të jetë 1,6%. Siç dëshmohet nga numrat, një shqetësim serioz ka të bëjë me shkollat e mesme, ku numri i braktisësve është rritur në krahasim me vitin e kaluar. Prandaj, mund të supozohet se strategjia aktuale nuk është plotësisht e efektshme bazuar në statistikat aktuale. Për të arritur një ulje apo reduktim të ndjeshëm të numrit të fëmijëve jashtë shkollës, është e nevojshme të identifikohet numri i përgjithshëm i rasteve aktuale dhe pastaj të vlerësohet efektiviteti i mekanizmave parandalues në terren.

<sup>11</sup> <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2016-17-shqip.pdf>

<sup>12</sup> <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/korniza-e-treguesve.pdf>

Një fokus i veçantë duhet t'u kushtohet nxënësve që i përkasin grupeve të marginalizuara dhe të cenueshme në Kosovë. Siç është përmendur tashmë, fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë pengesa serioze në arsim dhe në procesin mësimor. Për fat të keq, nuk ka të dhëna të përditësuara për situatën aktuale. Edhe pse vlerësimet e bëra në vitin 2012 të kryera nga OJQ-ja kosovare "Balkan Sunflower" kishin paraqitur një situatë alarmante, mjaft serioze, në lidhje me gjeneratën e atëhershme. Sipas sondazhit, 36% e asaj gjenerate me theks të veçantë fëmijëve të grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara nuk kanë asnjë lloj edukimi institucional fare. Ndërsa gjatë periudhës së Ish-Jugosllavisë të gjithë ishin të përfshirë në mënyrë të detyrueshme në sistemin arsimor, pas luftës së fundit në Kosovë normat e pjesëmarrjes në arsimin e detyrueshëm ka rënë ndjeshëm. Siç edhe e prezantuar Raportin e Kosovo 2.0 "Të mbajtur dhe të përjashtuar"<sup>13</sup> i vitit 2016, arsyet prapa këtij fenomeni janë kryesisht faktorë ekonomikë dhe distanca të gjata gjeografike nga shkollat. Për më tepër, fëmijët në ditët e sotme vuajnë pasojat e luftës të shkaktuar ndaj prindërve të tyre, si mungesa e arsimimit dhe analfabetizmit. Në fakt, është shumë e vështirë për këta fëmijë të kuptojnë rëndësinë e edukimit dhe të kulturës, ndërsa prindërit e tyre duhet të luftojnë çdo ditë për të ushqyer familjet e tyre. Prandaj, qasja në arsim dhe vijimi në arsimin e detyrueshëm për komunitetet e cenueshme dhe të marginalizuara ende duhet të konsiderohet shumë e ulët. Varfëria dhe papunësia ndikojnë thellë në ekonominë familjare, duke kërkuar fuqi punëtore për të siguruar para. Në rastet më të këqija, fëmijët përfaqësojnë një forcë pune për tu shfrytëzuar dhe u kërkohet të kontribuojnë për të ardhurat e familjes, si prioritet ndaj gjërave të tjera për të siguruar mbijetesën. Brenda këtij konteksti, është ulur ndjeshëm roli arsimor. Raporti vjetor i Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë i vitit 2013/2014 thotë se në arsimin fillor shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë është 78,7% (17,5% më pak në krahasim me shkallën e përgjithshme të pjesëmarrjes në Kosovë) dhe në shkollat e mesme, vetëm 16,5%. Megjithatë, pasaktësia e të dhënave ndodh për shkak se sistemi nuk arrin të llogarisë asnjëherë numrin e plotë të këtyre fëmijëve: pasi që një numër prej tyre nuk janë regjistruar në sistemin arsimor, është jashtëzakonisht e vështirë të identifikohen rastet e atyre fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollë.

Përveç kësaj, fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jo rrallë përballen me probleme të diskriminimit dhe segregacionit duke bërë që ata të braktisin shkollën. Kjo çështje bazohet në fakte të vërteta të raportuara në Koalicionin për të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC). Mes tjerash, në Prizren është regjistruar një menaxhim i suksesshëm i një rasti të tillë në gusht të vitit 2017, ku është përfshirë një fëmijë rom nxënës i shkollës fillore (shih Shtojcën 1). Ky fëmijë kishte përjetuar ngacmime dhe diskriminim nga moshatarët, për këtë arsye pjesëmarrja në shkollë për këtë fëmijë u bë e patolerueshme. Nga frika se gjendja mund t'i përkeqësohet edhe më shumë, ai asnjëherë nuk i ka raportuar shqetësimet e tij mësuesve apo prindërve, të cilët, duke marrë për bazë sfondin e tij shoqëror, pas kishte braktisur shkollën nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim për të kthyer dhe ri-integruar fëmijën në shkollë. Falë ndërhyrjes së asistentëve ligjor të Koalicionit ERAC, jo vetëm që fëmija u ri-integrua, por edhe u ndërgjegjësuam aktorët përkatës për përdorimin e modulit të Parandalimit të hershëm dhe funksionalizimit të EPRBM-së në nivel të shkollës ku ky fëmijë kishte ndjekur mësimet. Fatmirësisht, kjo paraqet një rast pozitiv ku mekanizmat ekzistues kanë rezultuar efikase, megjithatë është me prioritet të lartë për të fuqizuar mekanizmat për identifikimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes së mësimi.

Një vërejtje e posaçme duhet të bëhet në lidhje me arsimin për fëmijët me nevoja të veçanta. Sipas statistikave të fundit të publikuara nga MASHT-i, numri i përgjithshëm i nxënësve të diagnostikuar me nevoja të veçanta është 5'294, në 41% të fëmijëve me nevoja të veçanta janë

<sup>13</sup> <http://kosovotwopointzero.com/en/held-back-and-excluded/>

femra, pjesa tjetër janë meshkuj. Llojet e nevojave të veçanta janë të natyrës intelektuale, fizike, të komunikuarit, fëmijët autikë, probleme emocionale, fëmijët me sindromë Down, dëmtim në të dëgjuar, folur dhe të parë. Këto kategori të nxënësve duhet të trajtohen nëpërmjet krijimit të një mjedisi të barabartë dhe gjithëpërfshirës arsimor me qëllim që të sigurohet jo vetëm arsimimi i detyrueshëm, por edhe përmbushja e nevojave specifike të këtyre fëmijëve.

Duke marrë parasysh situatën e përshkruar, ky hulumtim synon të hedh dritë mbi vështirësitë në zbatimin e zgjidhjeve të qëndrueshme, drejt një përpjekjeje të plotë sociale për të zgjidhur problemet e kësaj natyre. Sapo të kuptohet se gjendja aktuale për sa i përket funksionimit të mekanizmave për parandalimin e braktisjes së mësimi është jo e mirë, është thelbësore që të synohen pikat e dobëta ose të forta të procesit, për të nxitur bashkëpunimin midis mekanizmave administrativë dhe për të nxjerrë rekomandime për zgjidhje pragmatike dhe të qëndrueshme. Ky hulumtim synon të përshtatet me këtë qëllim.

## Korniza Legjislative

Parimet themelore të të drejtave të njeriut janë të bazuara fuqishëm në Kushtetutën e Kosovës. Korniza legjislative e Kosovës premtion dhe mbështet qasjen gjithëpërfshirëse në arsim; për shembull, ligjet në lidhje me arsimin e rregullt dhe atë profesional në nivel të vendit përfshijnë udhëzime specifike për luftën kundër braktisjes së parakohshme nga arsimi i detyrueshëm dhe qasja e barabartë në shkollim. Duke filluar me Ligjin kundër diskriminimit<sup>14</sup> (2004), neni 4 mbi fushën e zbatimit siguron qasje të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe formimit profesional pa asnjë diskriminim mbi gjininë, përkatësinë etnike ose aftësinë e kufizuar. Një koncept i ngjashëm është dhënë në Ligjin NR. 03/L-068 për arsimin në komunat e Kosovës<sup>15</sup>, ku në mesin e përgjegjësive që u janë besuar autoriteteve komunale, pranimi i nxënësve në shkolla bëhet me respekt e duhur për parimet e mosdiskriminimit. Në përputhje me këtë, Ligji për arsimin parashkollor<sup>16</sup> përqendrohet në karakterin gjithëpërfshirës të arsimit, të siguruar nga artikulli i parë. Përfshirja pa asnjë dallim dhe barazia janë të mbështetura nga një pjesëmarrje efektive e prindërve (neni 4) drejt një zhvillimi të plotë të personalitetit të fëmijëve. Megjithatë, masat më afirmative kundër braktisjes së shkollës janë përfshirë në Ligjin për arsimin parauniversitar<sup>17</sup>. Në këtë ligj, arsimi paraqitet si një përgjegjësi e përbashkët midis familjes, institucioneve publike, komunës dhe qeverisë (neni 3). Sipas këtij ligji, qasja dhe progresi në shkollë mundësohen pa ndonjë diskriminim në ndonjë bazë reale ose të supozuar.

Sipas Komitetit të mëparshëm të Task Forcës në vitin 2005 (i krijuar sipas UA 13/2005), nxënësit që kanë braktisur mësimin përcaktohen si nxënës që nuk regjistrohen në shkollë ose që largohen nga shkolla para përfundimit të arsimit të detyrueshëm. Ky përkufizim është zhvilluar brenda kontekstit kosovar për një kuptim më të mirë të shkaqeve dhe faktorëve. Është përgjithësisht e njohur që braktisja e hershme e shkollës është një humbje e madhe për shoqërinë dhe rezultatet e saj, pasi mungesa e arsimit formal është, ndër të tjera, arsye kryesore e nivelit të papunësisë. Në fakt, një sistem solid arsimor gjithëpërfshirës është baza për fuqizimin e kapaciteteve ekonomike të një vendi për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare. Meqenëse studentët që kanë braktisur

<sup>14</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji kundër diskriminimit, 2004.

[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004\\_3\\_en.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_3_en.pdf)

<sup>15</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji për arsimin në komunat e Kosovës. Neni 3, paragrafi (b), 2015.

<http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/09-2008-03-1068-en.pdf>

<sup>16</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji për arsimin parashkollor, 2006.

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/08-2006-02-152-en.pdf>

<sup>17</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji për arsimin parauniversitar, 2011.

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preuniversity%20education.pdf>



mësimin përgjithësisht paraqesin vështirësi në aftësitë themelore dhe në aftësitë e të mësuarit afatgjatë, braktisja e shkollave minon pjesëmarrjen efektive të vendit në politikat evropiane të integritetit. Prioritetet kryesore arsimore drejt një qasje gjithëpërfshirëse janë zvogëlimi i numrit të nxënësve jashtë shkollës në mesin e fëmijëve të cenueshëm dhe të pa-favorizuara dhe promovimi i praktikave të mira për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme. Pas luftës, komunitetet më të përjashtuara dhe të rrezikuara në Kosovë kanë qenë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Margjinalizimi social ndikon seriozisht nivelin arsimor të fëmijëve që u përkasin këtyre grupeve për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe vetëdijesimit të pamjaftueshëm të prindërve. Që nga viti 2013 nën mbikëqyrjen e Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë në bashkëpunim me ECMI Kosovën dhe UNICEF-in është bërë një punë e madhe dhe angazhim në implementimin e Udhëzimit administrativ (UA 19/2012 tash se fundi i rishikuar dhe ndryshuar në UA 08/2018) për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe funksionalizimin e ekipeve për parandalim dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit (EPRBM) të lëshuar nga Departamenti për politikën e arsimit parauniversitar/MASHT.

Vëmendje më e madhe i kushtohet mbrojtjes së grupeve të cenueshme brenda shoqërisë kosovare. Në veçanti, korniza ligjore kosovare mbështet masat për të parandaluar fenomenin e braktisjes dhe mbështet arsimin gjithëpërfshirës me asistencë teknike. Megjithatë, veprimet efektive kundër braktisjes së shkollës duhet të kryhen në nivel lokal nën mbikëqyrjen e komunave. Decentralizimi në të vërtetë përbën një qasje bazë, të strukturuar nëpërmjet bashkëpunimit të prindërve, policisë dhe autoriteteve të tjera përkatëse. Braktisja si një problem shumëdimensional, rrjedh nga një ndjenjë më e gjerë e shqyçjes dhe tjetërsimit dhe prandaj ka nevojë për tu trajtuar nëpërmjet një qasjeje sistematike. MASHT-i jep udhëzime për komunat dhe institucionet lokale për siguruar një pjesëmarrje të plotë në shkollë, për shembull sigurimin e transportit publik. Së fundi, parimi i arsimit gjithëpërfshirës i parashikuar në nenin 40 të Kushtetutës garanton strehimin e të gjithë fëmijëve pavarësisht nga tiparet e tyre fizike, intelektuale, shoqërore dhe gjuhësore.

## Strategjitë e fundit qeveritare

Të dhënat e ofruara nga MASHT-i në vitin 2016<sup>18</sup> tregojnë për një rënie të shkallës së braktisjes së mësimin nga viti 2011 deri në 2014, nga 0,48% në 0,12%. Një analizë me bazë gjinore e të gjitha të dhënave tregon një dallim të rëndësishëm midis nxënësve meshkuj dhe femra që braktisin mësimin: 26,7% femra dhe 73,3% meshkuj. Shpjegimi i fenomenit të braktisjes të ofruar nga MASHT-i duhet të eksplorohe në planin e përkeqësimit të situatës ekonomike dhe standardit të jetesës së familjeve. Nxënësit e rinj të gjinisë mashkullore shpesh shihen si një fuqi potenciale punëtore për të rritur të ardhurat e familjes. Duke marrë parasysh rëndësinë e rënies së braktisjes së shkollës, Strategjia aktuale e Arsimit (2017-2021) përfshin synime specifike në lidhje me situatën aktuale.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë për periudhën 2017-2021 trajton në mënyrë eksplicite çështjen e braktisjes së hershme të shkollës, megjithëse shkalla e braktisjes së shkollës ka rënë gjatë gjashtë viteve të fundit. Siç është theksuar në PSAK, mospërputhjet e të dhënave të frekuentimit të mësimin/shkollës ende paraqesin një pengesë të madhe në procesin e monitorimit. Lëvizja e popullsisë brenda dhe jashtë vendit shkakton probleme shtesë për sa i përket braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë. Për shembull, një shqetësim serioz është kategoria e nxënësve të kthyer: ata fëmijë, familjet e të cilëve u larguan nga Kosova gjatë luftës dhe u kthyen në vendet e tyre të lindjes. Integrimi i tyre në sistemin shkollor duhet të mbështetet nga një bashkëpunim

<sup>18</sup> PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË, 2017-2021. Kosovë, 2016. Faqe 23.

[http://keen-ks.net/site/assets/files/1387/kosovo\\_education\\_strategic\\_plan\\_2017-2021\\_-\\_eng.pdf](http://keen-ks.net/site/assets/files/1387/kosovo_education_strategic_plan_2017-2021_-_eng.pdf)

i intensifikuar midis Drejtorëve Komunal të Arsimit (DKA-ve) dhe MASHT-it, veçanërisht lidhur me procedurat administrative dhe grumbullimin dhe administrimin e të dhënave. Prandaj, rreziku i braktisjes së shkollës ende qëndron si një sfidë në lidhje me përparimin arsimor dhe edukativ të vendit. Sipas një Urdhërese të MASHT-it, ndërgjegjësimi i ulët dhe jo-adekuat në zonat rurale dhe mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve përkatëse ndikon negativisht në shkallën e regjistrimit në shkollë. Për të zbatuar plotësisht kuadrin ligjor që adreson këtë fenomen, duhet forcuar bashkëpunimi mes shkollave, administratave lokale dhe qeverisë qendrore. Për përmirësimin e efektivitetit përmes mekanizmave ekzistues, udhëzimet e lëshuara nga autoriteti qendror (MASHT) për katër vitet e ardhshme përfshijnë mes tjerash: (1) fuqizimin e menaxhimit të kapaciteteve në shkolla dhe komuna, (2) rishikimin e kapaciteteve të EPRBM-ve (shkollore dhe komunale), (3) përmirësimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë, (4) zhvillimin e planeve të veprimit brenda shkollave/komunave, (5) monitorimin dhe vlerësimin e progresit, (6) programe të posaçme për përsheptimin e të nxënësve për ata nxënës njëherë braktisës dhe mandej të kthyer dhe ri-integruar në procesin mësimor.

Strategjia e propozuar nga qeveria është ka marrë parasysh qasjen e nevojshme ndërdisiplinore për të përballuar problemin, duke marrë parasysh faktorët socialë, individualë, familjarë dhe arsimorë. Grupet sociale të trajtuara nga strategjia e MASHT-it janë: fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e kthyer, fëmijët nga familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike, fëmijët nga komunitetet jo-shumicë, etj. Duke iu referuar Strategjisë për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve<sup>19</sup> (2011-2016) shkalla e braktisjes së shkollës është shqetësuese, ndërsa çështjet ekonomike janë ndër shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës. Shifrat bëhen veçanërisht shqetësuese kur bëhet fjalë për grupet e cenueshme dhe segmentet më të varfra të popullsisë, siç janë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Nxënësit nga këto komunitete, në veçanti, janë identifikuar si subjekt në rrezik për braktisjen e mësimi/shkollës. Në Planin e lartpërmendur (PSAK), arsyet për një pjesëmarrje të ulët të nxënësve që u përkasin këtyre tre komuniteteve duhet të gjenden në çështjet e diskriminimit, mungesës së qasjes në arsim, mungesës së zbatimit të ligjit. Në fakt, korrelacioni mes varfërisë dhe fëmijëve braktisës nuk mund të mohohet, siç edhe është pranuar përgjithësisht. Rrjedhimisht, vetëdija shoqërore duhet të rritet dhe të kanalizohet konkretisht përmes mekanizmave institucionalë të krijuar për t'u përballur me të gjitha rastet e braktisjes së shkollës.

## Korniza Institucionale

MASHT, UNICEF dhe ECMI Kosova bashkëpunojnë ngushtë në zbatimin e një sistemi të qëndrueshëm për trajtimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes, fëmijëve të regjistruar në shkollë por që nuk vijnë në mësimet ose i lënë ato, fëmijët që kanë ndjekin mësimet por nuk arrijnë të mësojnë ose zhvillohen dhe fëmijëve që regjistrohen për disa vite, por dështojnë të përparojnë. Prioritetet kryesore janë zvogëlimi i numrit të fëmijëve jashtë shkollës për fëmijët e komuniteteve të cenueshme dhe të pa-favorizuar përmes promovimit të praktikave të mira drejt institucionalizimit të zgjidhjeve të qëndrueshme që kontribuojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve. Si rezultat i identifikimit të sfidave dhe pengesave, plani i veprimit duhet të nxjerrë në pah ndërlikimet në gjetjen dhe vendosjen e zgjidhjeve të qëndrueshme në praktikë, pasi rreziku i braktisjes së shkollës ende paraqet një sfidë themelore në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021.

<sup>19</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kosovë. STRATEGJIA KOMBËTARE DHE PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË 2011-2016, qershor 2010.


[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA\\_DHE\\_PLANI\\_I\\_VEPRIMIT\\_PER\\_PARANDALIMIN\\_DHE\\_ELIMINIMIN\\_E\\_PUNES\\_SE\\_FEMIJEVE\\_NE\\_KOSOVE\\_2011\\_-\\_2016.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_DHE_PLANI_I_VEPRIMIT_PER_PARANDALIMIN_DHE_ELIMINIMIN_E_PUNES_SE_FEMIJEVE_NE_KOSOVE_2011_-_2016.pdf)

Duke marrë parasysh nevojën për një bashkëveprim të plotë në mes të komunitetit që rrethon fëmijët, janë themeluar dy lloje të EPRBM-ve: njëri që lidhet me veprim dhe angazhim në shkollës dhe tjetri me bazë në komunë si instancë e dytë përgjegjëse kur rastet dështojnë të gjejnë zgjidhje në EPRBM-në shkollore. Qëllimi i këtyre dy ekipeve është të bashkëpunojë horizontalisht dhe të përmirësojnë komunikimin ndërmjet komuniteteve dhe shkollave. Në të vërtetë, EPRBM-të komunale janë të bazuara dhe kanë shtrirje të gjerë me bazë në komunitet dhe bashkëpunojnë me OJQ-të lokale, qendrat për punë sociale, policinë, qendrat rinore, qendrat e mjekësisë familjare etj. Ekipet shkollore përbëhen nga të paktën 5 anëtarë: një përfaqësues I Këshillit të prindërve, dy mësues, një përfaqësues i Këshillit të nxënësve, dhe drejtori i shkollës si anëtarë të përhershëm dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme relevante dhe përfaqësues të OJQ-ve lokale si anëtarë korrespondentë. Më anë tjetër, EPRBM-të në nivel të shkollës përqendrohen më shumë tek fëmija dhe mjedisi i shkollës duke punuar së bashku me drejtorët e shkollave, përfaqësuesit e prindërve, mësuesit dhe nxënësit bashkëmoshatarë. Planet shkollore dhe veprimet komunale duhet të jenë në përputhje me direktivat e MASHT-it dhe duhet të konkurrojnë paralelisht me njëri-tjetrin. Rezultatet përfundimtare dhe performanca monitorohen nga Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA-të), të cilët kërkojnë raporte të shkruara rregullisht për progresin e arritur. Të gjitha informatat duhet të raportohen nëpërmjet Modulit të paralajmërimit të hershëm (SPH) një softuer ky i vendosur brenda sistemit më të gjerë të informacionit për menaxhimin e arsimit (SMIA), sipas UA 25/2013.



### Plani i veprimit në terren

Decentralizimi ka qenë deri më tani qasja më e përshtatshme për të trajtuar çështjen e fëmijëve jashtë shkollës (FJSh-ve) për një zbatim efektiv të zgjidhjeve të qëndrueshme. Siç pohohet në dokumentin Monitorimi i pjesëmarrjes në arsim të hartuar nga UNICEF dhe Statistikat e UNESCO-së, parandalimi përfaqëson iniciativën aktuale për të adresuar çështjen e fëmijëve jashtë shkolle.



Sesionet e trajnimeve janë organizuar që nga viti 2013 nga Ministria e Arsimit në Kosovë në bashkëpunim të ngushtë me ECMI Kosovën dhe UNICEF-in me qëllim të krijimit të një rrjeti të domosdoshëm dhe të nevojshëm të trajnerëve në 30-komuna të Kosovës. Detyra e tyre ishte të përgatisnin EPRBM-të shkollore/komunale për t'u marrë me çështjen e braktisjes duke përdorur mjetet e ofruara (fletë treguesin, SPH-në, grumbullimin e të dhënave të nevojshme, procesin e riintegritimit në shkollë). Mjeti kyç në këtë proces është Sistemi SMIA i definuar si "një njësi e shërbimit institucional që prodhon, menaxhon dhe shpërndan të dhëna dhe informacione mbi arsimin në Kosovë, zakonisht në nivel të MASHT-it ose departamenteve përkatëse të arsimit", funksionet e të cilit përfshijnë "mbledhjen, integrimin, përpunimin, organizimin, nxjerrjen dhe marketingun e të dhënave arsimore dhe statistikave në një mënyrë të besueshme dhe në kohë reale"<sup>20</sup>. Trajnerët janë certifikuar nga MASHT me Programin e Trajnimit për Trajnerë (PTT) dhe manualet për përdorimin e SMIA-së u janë shpërndarë ekipeve përkatëse për t'i udhëzuar ata për përdorimin teknik dhe përmbajtësor të moduleve përkatëse. ECMI Kosova ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit (MM) me secilën prej komunave të përfshira në veprimet e projekteve të saj për të paraqitur programin e përbashkët të arsimit të hartuar nga MASHT/UNICEF/ECMI Kosovë. Pritjet ideale të këtij procesi ishin të trajnonte dhe forconte burimet njerëzore në terren; për të siguruar rezultate të suksesshme, përgatitje profesionale dhe zhvillim të aftësive në të gjitha nivelet.

<sup>20</sup> Monitorimi i pjesëmarrjes në arsim: Korniza për monitorimin e fëmijëve dhe adoleshentëve që janë jashtë Shkollës ose në rrezik të braktisjes. UNICEF dhe ISU, faqe - 10.

Pika nismëtare e krejt procesit të trajnimit ishte rritja e ndërgjegjësimit të zyrtarëve komunalë dhe institucionalizimi i angazhimit dhe vullnetit të mirë të tyre për t'u përqendruar në problemin e braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë. Së dyti, përgatitja është përqendruar në të mësuarit e sistematizimit të procedurave për të adresuar çështjet e fëmijëve jashtë shkollës—duke përdorur softuerë të veçantë të zhvilluar nga MASHT dhe Edu-Soft, të tilla si SPH (Sistemi i paralajmërimit të hershëm) dhe SMIA. Prandaj, trajnimet në këtë fazë janë realizuar në të mësuarit konkret dhe teknik mbi mënyrën e përdorimit të mjeteve për identifikimin e nxënësve braktisës dhe atyre në rrezik të lartë të braktisjes. Rezultati i mëvonshëm i kësaj faze ishte ndërtimi i kapaciteteve të EPRBM-ve në nivel të shkollave dhe komunave. Trajnerët pasi kishin marrë instruksionet dhe aftësitë e nevojshme të ofruar nga ekspertët e MASHT-it, kanë vazhduar të ofrojnë trajnime në komunat përkatëse për të udhëzuar anëtarët e EPRBM-ve se si të zbatojnë procedurat për parandalimin e braktisjes së fëmijëve dhe si të trajtojnë rastet në rrezik të braktisjes. Kjo ka sjellë në fazën përfundimtare të praktikave të mira, që është rritja e pronësisë dhe përgjegjësisë së aktorëve të përfshirë për një qasje gjithëpërfshirëse të problemit dhe mentorimit/monitorimit të aktiviteteve të EPRBM-ve përkatëse. Puna e EPRBM-ve në nivel të shkollës dhe komunave duhet të bazohet në Planet e Veprimt për të siguruar barazinë e plotë në qasjen në shkollë dhe mbajtjen në sistem të nxënësve të rrezikuar që zakonisht u përkasin grupeve më të marginalizuara të komunitetit. Sistemi gjithashtu kërkon një dokumentim të detajuar të rasteve dhe të dhënave të trajtuara nëpërmjet Modullit: Sistemi i paralajmërimit të hershëm. Anëtarët e EPRBM-ve shkollore duhet të referojnë në një bazë apo afat kohor tremujor tek EPRBM-të komunale, në mënyrë që sistemi i informacionit të përditësohet dhe të njoftojë për secilin rast alarmues apo në nevojë urgjente për tu trajtuar nga instanca e dytë përgjegjëse. Drejtoria Arsimore Komonale (DKA) është e angazhuar në monitorimin e punës dhe rezultateve të veprimeve të ekipeve të të dy niveleve. Megjithatë, për shkak të shtrirjes më të gjerë të programit të trajnimit, identifikimi i anëtarëve të PRTAN-it është mbështetur nga motivimi dhe përvoja si dy kritere kryesore. Tryezat e rregullta të grupit qendror të punës për arsimin kontribuojnë për avokim dhe zbatimin e aktiviteteve të parapara të përfshira në axhendën e Planit Kombëtar për parandalimin e braktisjes së mësimit.

Roli i ECMI Kosovës, tash e dhjetë vite, ishte të mbështeste të gjithë procesin, duke filluar nga organizimi i seminareve trajnuese dhe punëtorive, deri në fazën përfundimtare të monitorimit të funksionalizimit të EPRBM-ve dhe zbatimit të të gjitha instrumenteve të dizajnuar për këtë qëllim, nëpërmjet një bashkëpunimi të vendosur me palët e interesuara në nivel qendror dhe komunal. Roli i ECMI Kosovës, për më tepër, në këtë fushë është lidhja e shkollave me palët e interesuara në komunitet, me qëllim të krijimit të një rrjeti të qëndrueshëm që trajton çdo fëmijë në rrezik të braktisjes së shkollës. Procesi i menaxhimit të rasteve në të vërtetë përfshihet në shumë dimensione nga komuniteti apo aktorët në nivel lokal: (1) rasti i një fëmije në rrezik të braktisjes së shkollës fillimisht diskutohet brenda mjedisit shkollor, të udhëhequr nga EPRBM-ja shkollore; (2) një bisedë private me fëmijën me qëllim identifikimit të vështirësive të mundshme në të nxënë dhe ngritjen e interesit të tij për arsimim; (3) nëse procesi nuk arrin deri te ndonjë rezultat në kohë reale, atëherë kërkohet përfshirja e aktorëve të komunitetit respektivisht instancave të tjera përgjegjëse. Ekspertët i referohen prindërve dhe mbështetjes psikologjike nga qendrat mjekësore dhe palët e tjera të interesuara deri në riintegrimin e plotë të nxënësit/es në shkollë. Drejtoritë e tjera komunale që mund të përfshihen drejtpërsëdrejti janë: Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale (DSMS) dhe Drejtoria komunale për kulturë, rini dhe sport (DKKRS), dhe zyrat e tjera relevante si Zyra e regjistrimit civil, Qendra për punë sociale (QPS), Qendra e mjekësisë familjare (QMF), dhe Zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK).

Në vitin 2017 aktivitetet e realizuara në terren kanë qenë të fokusuara drejt fuqizimit të mekanizmave tashmë të institucionalizuar në reduktimin e numrit të fëmijëve jashtë shkollës dhe zvogëlimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët që u përkasin komuniteteve të cenueshme dhe të pa-favorizuar në 30 komuna të Kosovës. ECMI Kosova ka trajtuar këto çështje nëpërmjet angazhimit të konsulentëve të jashtëm që kanë ofruar ekspertizë specifike profesionale për rezultate më efektive në sesionet trajnuese.

Task Forca e mëparshme e Kosovës e themeluar në vitin 2005 për të trajtuar këtë çështje, tashmë ka supozuar se efektiviteti i zgjidhjes së problemeve nuk rezulton nga ndërhyrjet e vonshme, por përkundrazi nga mbështetja sistematike dhënë sistemit të ndërhyrjes së hershme. Ky supozim është absorbuar gjerësisht nga mekanizmat e mëvonshëm respektivisht grupet e punës të themeluar në kuadër të UA 19/2012. Me ç'rast është konstatuar se parandalimi është qasja më e mire që duhet aplikuar kundër braktisjes së shkollës. Prandaj është me rëndësi të madhe të institucionalizohet mekanizmi i identifikimit të nxënësve në rrezik të braktisjes. Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë mbështetet në zbatimin e Udhëzimit të lartpërmendur, tash së voni i rishikuar dhe ndryshuar në UA 08/2018, drejt një funksionalizimi të plotë të EPRBM-ve. Themelimi i këtyre ekspertë grupeve është modeluar në një qasje të decentralizimit, që synon t'i japë mbështetje të drejtpërdrejtë drejtorëve të shkollave, mësuesve dhe familjeve të nxënësve të prekur dhe të mbështesë një bashkëpunim ndër-sektorial. Roli i EPRBM-ve vepron në kuadër të një strategjie lartë dhe poshtë: monitorimi dhe grumbullimi i të dhënave gjatë menaxhimit të rasteve, zhvillimi i planeve të veprimit si përgjigje ndaj mos-regjistrimit në shkollë dhe braktisjes së shkollës, ndërhyrjet e menjëhershme dhe afatgjata, raportimi i çështjeve, ngritja e vetëdijes dhe sigurimi i një vëmendje të posaçme për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

## Arritjet

Për një vlerësim të një zgjidhjeje të qëndrueshme kundër braktisjes së shkollave dhe normës së mos-regjistrimit në shkollë, do të diskutohen arritjet e deritanishme në zbatimin e strategjisë.

Politika aktuale kundër braktisjes së mësimit dhe mos-regjistrimit në shkollë përqendrohet në krijimin e një qasjeje parandaluese më shumë sesa në vendosjen e një procedure reagimi ndaj braktisjeve. Në fakt, duke marrë parasysh situatën alarmante në lidhje me braktisjen dhe normën e mos-regjistrimit në shkollë para vitit 2016, mund të konstatohet një përmirësim i dukshëm në ditët e sotme. Rezultati i parë pozitiv i planit të punës ishte marrëveshja e nënshkruar me mbi 30 komunitatet e përfshira (Memorandumet e Mirëkuptimit). ECMI Kosova me mbështetje të parrezervë nga UNICEF ka asistuar MASHT-in në hartimin dhe shpërndarjen e doracakëve për punën e EPRBM-ve dhe më tej zgjerimin e monitorimit të fëmijëve jashtë shkollës në të gjitha komunitatet e përfshira në projektet e saj. Ndërmjet shkurtit dhe prillit 2017 u vendosën të gjitha ekipet për parandalimin e braktisjes së shkollës. Për të siguruar një përfshirje të plotë në sistemin arsimor të Kosovës, është thelbësore që të fuqizohet veprimi ad-hoc brenda komunitetit dhe familjeve. Misioni i ekspertëve të ECMI Kosovës është të punojë për zhvillimin e synimit të lartpërmendur drejt funksionalizimit të plotë të EPRBM-ve në komunitatet e synuara.

Pavarësisht rëndësisë së përfshirjes arsimore në kontekstin shoqëror, zbatimin të udhëzimeve/ vendimeve për të përmirësuar mbajtjen e fëmijëve në shkollë nuk iu kushtua vëmendje e mjaftueshme, sidomos në nivelin komunal. Rrjedhimisht, qëllim dhe synim i momentit është ofrimi i një mbështetje adekuate për të strukturuar një sistem të qëndrueshëm në kuadër të DKA-ve për t'u marrë me fëmijët në rrezik të braktisjes, fëmijëve të regjistruar në shkollë—por që

vijojnë shkollën në një formë episodike, fëmijët që ndjekin shkollën—por nuk arrijnë të mësojnë dhe fëmijët që janë të regjistruar për disa vite—por nuk kanë përparuar fare. Me qëllim që të zbatohet plotësisht ky sistem parandalimi siç pretendohet nga Udhëzimi Administrativ 19/2012 i ndryshuar kohët e fundit në 08/2018, është ende e nevojshme të vepohet në nivel shkolle, pasi që shkollat janë burimi kryesor i veprimeve dhe identifikimit të rasteve. Zhvillimi i kapaciteteve të ekipeve parandaluese duhet të fuqizohet. Për më tepër, të dhënat e mbledhura, sasiore dhe cilësore, do të ndihmojnë shkollat, DKA-të dhe MASHT-in të orientojnë politikën e ardhshme në përputhje me gjendjen faktike. Në të njëjtën mënyrë, DKA-të duhet të përqendrohen më shumë në nxitjen e koordinimit ndër-sektorial, veçanërisht duke marrë parasysh llojin e rasteve të referuara të cilat mund të kërkojnë përfshirjen e departamenteve të tjera në nivel të komunës, shoqërisë civile dhe/ose të komuniteteve lokale.

Së fundi, mund të pohohet se angazhimi për të siguruar barazinë në arsim dhe për të rritur ndërgjegjësimin për gjithëpërfshirje, është institucionalizuar përgjithësisht. Gjatë pranverës së vitit 2017, janë trajnuar 75 EPRBM shkollore në 14 komuna; pavarësisht se buxheti kishte përfshirë trajnime vetëm për dy EPRBM për secilën komunë, një numër shumë më i madh i EPRBM-ve kishin kërkuar të merrnin pjesë në trajnimet e organizuara, duke sugjeruar që trajnimet kishin mbërritur qëllimin dhe kishin krijuar përshtypje të kënaqshme në mesin e pjesëmarrësve. Më vonë gjatë vitit 2017, edhe 7 komuna të tjera shtesë u përfshinë në program, duke rezultuar në gjithsej 44 EPRBM shkollore të trajnuara. Ndërsa gjatë pushimit veror, është zhvilluar një fazë monitorimi, në lidhje me punën dhe funksionimin e EPRBM-ve shkollore dhe komunale. Në këtë rrethanë, MASHT-i dhe ECMI Kosova kanë shpërndarë një pyetësor për qëllime monitorimi. Janë bërë vlerësime të ndryshme në të gjithë territorin e Kosovës, edhe pse procesi ka arritur një formë të tretë të fuqizimit nëpërmjet praktikës së mirë në lidhje me ngritjen e kapaciteteve entiteteve dhe aktorëve të përfshirë.

Duke pasur parasysh hezitimin fillestar të komunave për të ftuar ekspertët, për shkak të një skepticizmi ndaj mekanizmit të propozuar, sukcesi përfundimtar i punëtorive të ofruara tregon se është arritur një nivel shumë pozitiv i ndërgjegjësimit. Orientimi praktik i punëtorive në terren u konkretizua në një qasje të bazuar në dëshmi, nëpërmjet përshtimit dhe diskutimit të rasteve reale. Për të përmbledhur, duke marrë parasysh rezultatet e mira të seancave trajnuese, mund të pohohet se institucionalizimi i një sistemi uniform në menaxhimin e rasteve specifike është arritur në një masë të caktuar, por që lë akoma shumë për të dëshiruar. Përveç kësaj, integrimi i fëmijëve jashtë shkollave përmes një edukimi joformal është paraqitur si një zgjidhje e qëndrueshme midis aktorëve lokalë.

Një konsideratë përfundimtare i përket nxënësve me nevoja të veçanta arsimore; në vitin 2011, vetëm 33% të nxënësve të identifikuar me nevoja të veçanta janë regjistruar në arsimin parauniversitar. Aktualisht, përpjekjet drejt përmirësimit të kësaj kategorie arsimore kanë rritur përfshirjen e këtyre nxënësve në klasë të rregullta, edhe pse vërehet mungesa në zbatimin të procedurave standarde. Në përgjithësi, kushtet për një ambient arsimor gjithëpërfshirës në Kosovë kanë qenë të suksesshme. Megjithatë, rezultatet edhe më tutje duken të jenë mjaft të larmishme brenda komunave. Për hir të këtij hulumtimi, pengesat ekzistuese do të theksohen dhe shtjellohen në më shumë detaje në seksionin e ardhshëm.

## Sfidat në terren

Janë vënë re bllokime në pothuajse të gjitha fazat, duke ndikuar në ngadalësimin e zbatimit të procesit. Pengesat e hasura në fazën e parë të zbatimit të udhëzimit të mëhershëm—UA 19/2012—janë përgjithësisht të kapërcyera. Duke u nisur nga rezistenca dhe hezitimi i zyrtarëve komunalë për t'u trajnuar, deri në neglizhencën e dukshme të mos themelimit të EPRBM-ve komunale në ciklin e parë të projektit. Vështirësitë për të ngritur ndërgjegjen e aktorëve lokalë (palëve të interesuara) ka ndikuar në koordinimin midis aktorëve socialë dhe ka kufizuar zhvillimin e planeve komunale të veprimit. Ndërkohë që është bërë progres në themelimin e EPRBM-ve komunale, në disa raste nuk kanë qenë fare funksionale. Përpjekja për përdorimin e shpjegimeve të ofruara gjatë sesionit të trajnimeve dhe zbatimi i tyre në praktikë shpesh konsiderohej si punë shtesë e palëve të përfshira. Nëse në njërin anë – shumë shkolla, kanë treguar një angazhim të fortë në zbatimin e zgjidhjeve të qëndrueshme, nga ana tjetër përkushtimi në nivel të ekipeve komunale ndryshon nga komuna në komunë. Nevoja për një përfshirje afatgjatë në trajnimin e EPRBM-ve dhe në procesin e monitorimit për të arritur një qasje sistematike, ka qenë diçka që është kërkuar prej shumë zyrtarëve komunalë. Megjithatë, pjesëmarrja dhe mbështetja e ofruara nga përfaqësuesit e MASHT-it ka lehtësuar zhvillimin e të gjitha aktiviteteve në terren.

Duke u përqendruar në aspektin teknik të realizimit të kërkesave ndaj ekipeve përkatëse, problemi kryesor ishte përdorimi korrekt i instrumenteve të parashikuara për menaxhimin e rasteve (fletë identifikimi dhe moduli i SPH-së) ose edhe mos aplikimi i tyre në proces. Kjo veçanërisht ka ndikuar në identifikimin e nxënësve në rrezik të braktisjes dhe mungesës së dokumentimit të veprimeve të ndërmarra, aktiviteteve si dhe raportimit të punës së EPRBM-ve shkollore. Rëndësia e krijimit të një baze të dhënash për menaxhimin e rasteve është nënvlerësuar nga komunat, duke rezultuar në mungesë të kapaciteteve në krijimin e një sistemi precedentësh që është shumë i nevojshëm për trajtimin e çdo rasti apo situatë të ardhshme. Edhe procesi i mbajtjes së procesverbaleve të mbledhjeve nuk është zbatuar fare ose në raste shumë të rralla, sikur që dështimi për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta siç të udhëzuar. Duke i marrë parasysh këto rrethana, zhvillimi i planeve të veprimit në nivel të shkollës ka qenë në shumë raste jo i rregullt. Mungesa e një strukture efektive të raportimit - edhe për shkak të problemeve të mungesës së kuadrit në nivel komunal, kanë qenë ndër ndërlikimet më të mëdha në proces. Nevoja e angazhimit të organeve tjera përkatëse (si policia, punonjësit socialë, qendrat e të rinjve, qendrat e mjekësisë familjare) është konsideruar shumë e nevojshme për mekanizmin komunal në përpjekje për të mbajtur një fëmijë të braktisur.

Siç pretendohet nga Iniciativa Globale për Fëmijët jashtë shkollave, arsimit gjithëpërfshirës është një prioritet aktual brenda kornizave të drejtave të fëmijëve. Pas konstatimit të ndërlidhjes së drejtpërdrejtë dhe/apo korrelacionit midis nivelit arsimor dhe shkollës së papunësisë, është detyrë civile dhe politike e gjithsecilit shtet të garantojë një qasje të lirë dhe të barabartë në arsim. UNICEF-i kohët e fundit ka modeluar një qasje të re për të trajtuar çështjen, të bazuar në parandalim dhe mbështetje ad-hoc. Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm (SPH) dhe Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) janë metodat aktuale në zbatim të strukturuar në vendet e synuara, siç është Kosova. Ndonëse shkalla e braktisjes ka rënë ndjeshëm nga 0,48% në 2011 në 0,12% në 2014, rreziku i braktisjes së shkollës ende paraqet një sfidë themelore në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021.

Qëllimi i kësaj analize të kryer nga Koalicioni ERAC të udhëhequr nga ECMI Kosova ka për qëllim të ndjekë progresin e institucionalizimit të zgjidhjeve të qëndrueshme të kryera nga palët e interesuara përmes një procesi të decentralizuar. Nga të gjeturat e mbledhura në terren nga MASHT-i dhe ekipi i ECMI Kosovës, mund të konstatohet se politikat për parandalimin, identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve në rrezik të braktisjes dhe atyre që kanë braktisur shkollën janë mjaft të konsoliduar dhe përmbajtjesore. EPRBM-të e themeluara shkollë dhe komunale po përpunohen të ndihmojnë nxënësit e identifikuar në rrezik për të braktisur shkollën fillore dhe për të përfunduar ciklin bazë shkollor për t'i dhënë atyre një gamë të mundësive më të mira dhe më të qëndrueshme për të ardhmen. Pavarësisht rëndësisë së madhe të arsimit gjithëpërfshirës në kontekstin shoqëror, politikat, mekanizmat dhe instrumentet e dizajnuara për të përmirësuar mbajtjen dhe përparimin e fëmijëve/nxënësve në shkollën fillore nuk kanë marrë vëmendje të mjaftueshme në nivel lokal.

ECMI Kosova përmes projektit të financuar nga UNICEF-i ka ndërtuar një partneritet të qëndrueshëm me MASHT-in në ofrimin e një mbështetje të përshtatshme për të strukturuar një sistem të qëndrueshëm dhe për t'u marrë dhe trajtuar fëmijët në rrezik të braktisjes së shkollimit, fëmijët që janë regjistruar por që nuk vijojnë mësimet rregullisht, fëmijët që vijojnë rregullisht në shkollë—por që nuk nxënë dhe nuk përparojnë.

Në mënyrë që të zbatohet plotësisht ky sistem parandalimi, siç edhe kërkohet nga Udhëzimi Administrativ i miratuar së fundit 08/2019, është prioritet absolut të mbështeten shkollat si burimi kryesor i Planeve të Veprimt dhe identifikimit të rasteve në rrezik të braktisjes së mësimt. Në të njëjtën mënyrë, DKA-të duhet të përqendrohen më shumë në nxitjen e bashkëpunimit ndër-sektorial, veçanërisht duke pasur parasysh llojin dhe urgjencën e rasteve të referuara të cilat mund të kërkojnë një përfshirje shumë më të koordinuar të gjitha zyrave ose departamenteve të tjera komunale.

Në përgjithësi, të gjithë aktorët dhe palët e interesuara në të gjitha nivelet që angazhohen duhet të kenë përgjegjësinë dhe ndërgjegjësimin e duhur në lidhje me rolet, detyrat dhe përgjegjësitë që kanë për të siguruar gjithëpërfshirje në arsim, sipas kornizës ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut.



## REKOMANDIMET

Nga rezultatet e këtij studimi kemi hartuar një listë rekomandimesh bazuar në punën praktike në terren të kryer nga ekspertë të ECMI Kosovës dhe të koordinuara në një bashkëpunim të ngushtë me zyrtarët e MASHT-it. Synim prioritarë i këtij seti të rekomandimeve është forcimi i mekanizmave për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e detyrueshëm, siç përcaktohet në Planin strategjik të arsimit të Kosovës (KESP) 2017-2021.

### Rekomandime për shkollat

- Përmirësimi i vetëdijes në nivelin e shkollës.** Administratat shkollore duhet të mundësojnë një qasje të plotë në sistemin SMIA për EPRBM-të në nivel të shkollave. Drejtorët e shkollave duhet të angazhohen intensivisht në mënyrë që të mbajnë ekipet aktive dhe funksionale, duke filluar nga vendosja e marrëdhënieve të rregullta dhe takimeve me komunitetin dhe faktorë të tjerë relevantë jo-shkollorë për të adresuar të gjitha rastet dhe për të siguruar mbajtjen në shkollë të atyre fëmijëve në rrezik e braktisjes;
- Përfshirja efektive e mësuesve në mekanizmat e parandalimit të braktisjes së mësimi.** Mësuesit përgjegjës duhet të angazhohen vazhdimisht në identifikimin e hershëm të fëmijëve në rrezik të lartë të braktisjes së shkollës dhe t'i adresojnë ato në kohë reale në EPRBM-në e Shkollës - duke specifikuar në detaje problemet e identifikuar;
- Ofrimi i praktikave më efektive gjithëpërfshirëse në procesin e mësimi.** EPRBM-të shkollore, në koordinim me autoritetet e shkollës, duhet të promovojnë punën e tyre në drejtim të parandalimit dhe reagimit në mënyrë efektive ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë. Për të sigurua një përfshirjeje të barabartë në procesin mësimor, vëmendje e shtuar duhet t'i jepet rasteve të fëmijëve që ndjekin mësimin, por paraqesin vështirësi për të tjerët në procesin mësimor, fëmijët të cilët janë të regjistruar për disa vite në shkollë por që nuk përparojnë me mësim dhe fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Të sigurohet një përfshirje më e madhe e Këshillave të Shkollave.** Drejtorët e shkollave duhet të angazhohen më shumë për të sigurua një bashkëpunim aktiv dhe efektiv me prindërit dhe këshillat e nxënësve për të krijuar një mjet efikas drejt një angazhimi të përbashkët për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë, si dhe rastet tjera të fëmijëve me aftësi të kufizuara të nxënësve që ndjekin mësimin por nuk shfaqin asnjë progres arsimor/edukativ dhe fëmijëve me nevoja të veçanta.

### Rekomandime për DKA-të

- Funksionalizimi menjëhershëm i EPRBM-ve komunale.** DKA-të do të sigurojnë funksionalizimin e ekipeve komunale, në funksion të trajtimit të rasteve të adresuara tek ato nga ekipet shkollore. Procesi duhet të përfshijë një kontribut të domosdoshëm të sektorëve të tjerë socialë (mirëqenia, shëndeti, siguria etj.), Varësisht nga specifikat e rasteve të referuara;
- Hartimi dhe zbatimi i Planeve të veprimit.** Takimet e rregullta në nivel komunal janë të detyrueshme për një qasje të bazuar në dëshmi të Planeve të Veprimit. DKA-të do të integrojnë çështjen e parandalimit dhe reagimit ndaj braktisjes dhe moszgjidhjes në arsimin e

detyrueshëm në planin komunal ose do të hartojë një Plan Veprimi të veçantë Komunal - PKV, me qëllim të adresimit të pengesave për qasje në arsim;

- 3. Monitorimi i punës dhe ofrimi i mbështetjes së menjëhershme dhe të vazhdueshme ekipeve shkollore.** DKA-të duhet të sigurojnë një buxhet për të mbështetur aktivitetet e EPRBM-ve shkollore, veçanërisht në ato shkolla ku ka një numër të madh të rasteve që duhet adresuar nëpërmjet instrumenteve dhe modulit të SPH-së;
- 4. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale në nivelin lokal.** Nevojitet një përfshirje më e madhe e aktorëve të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë lokalë, duke promovuar rëndësinë e arsimit në komunitet dhe nevojën e një bashkëpunimi ndër-sektorial për të trajtuar braktisjen e mësimet. DKA-të duhet të identifikojnë dhe bashkërendojnë çështjet me partnerët e shoqërisë civile për të mbështetur zbatimin e politikave për adresimin e problemit të braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë;
- 5. Nxitja e bashkëpunimit me Këshillat e Shkollave.** DKA-të duhet të angazhohen më shumë për të siguruar një angazhim më pro-aktiv të këshillave të prindërve dhe të nxënësve për të krijuar një partneritet të duhur në angazhimin e përbashkët për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë, si dhe rastet e tjera të fëmijëve problematikë dhe trazovaçë të cilët ndjekin mësimet por dështojnë të rrisin kapacitete e tyre edukative/ arsimore dhe fëmijëve me nevoja të veçanta.

### Rekomandime për MASHT-in

- 1. Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve të EPRBM-së në nivel vendi.** MASHT-i duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje fuqizimit të EPRBM-ve në nivel kombëtar, duke përfshirë të gjitha mekanizmat e nevojshme shumë-disiplinore;
- 2. Rritja e menjëhershme e mekanizmit të monitorimit.** MASHT-i, respektivisht departamenti i inspektoratit, duhet të rrisë mbikëqyrjen për zbatimin e politikave kombëtare kundër braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e detyrueshëm. Në veçanti, zbatimi i mundshëm i Ligjit të ri për Inspektim paraqet pikënisje për ekzekutimin e mekanizmit të monitorimit, si dhe për bashkërendimin e çështjeve mes DKA-ve dhe shkollave;
- 3. Fuqizimi i burimeve njerëzore.** MASHT-i duhet t'i mbështesë DKA-të dhe shkollat për të fuqizuar EPRBM-të përkatëse, për t'i bërë ato plotësisht funksionale dhe kompetente për të kryer detyrat sipas mandatit të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (së fundit të ndryshuar në 08/2018). Duke marrë parasysh mungesën aktuale të koordinimit në mes të akterëve komunalë dhe shkollave, MASHT-i duhet të garantojë ekzekutimin efektiv të udhëzimeve dhe vendimeve të miratuara kundër fenomenit të braktisjes drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të dinjitetshme shoqërore;
- 4. Rritja e volumit të bashkëpunimit me palë të treta.** MASHT-i duhet të vazhdojë të koordinojë të gjitha çështjet e ndërlidhura me partnerë të interesuar në adresimin e problemit të braktisjes dhe forcimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm kundër braktisjes.



## REFERENCAT

### MARREVESHJET NDERKOMBETARE

Konventa kundër Diskriminimit në Arsim. UNESCO, 1960.

[http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL\\_ID=12949&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=12949&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

Deklarata e Incheon-it. Arsimi 2030: Drejt arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë, 2015.

<https://en.unesco.org/world-education-forum-2015/incheon-declaration>

Kuadri për Veprim për Zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 4— Arsimi 2030.

<http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002456/245656E.pdf>

MEST, 2015. Raporti i vlerësimit të Planit strategjik të arsimit të Kosovës 2011-2016. MASHT, 2015.

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-eng-web.pdf>

### LIGJET VENDORE

Ligji kundër diskriminimit. Kuvendi i Kosovës, 2004.

[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004\\_3\\_en.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_3_en.pdf)

Ligji për arsimin në komunat e Kosovës. Kuvendi i Kosovës, 2008.

<http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/09-2008-03-l068-en.pdf>

Ligji për arsimin parashkollor. Kuvendi i Kosovës, 2006.

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/08-2006-02-l52-en.pdf>

Ligji për arsimin parauniversitar. Kuvendi i Kosovës, 2011.

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preuniversity%20education.pdf>

Strategjia kombëtare dhe Plani i veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë, 2011-2016. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kosovë, 2010.

[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategy\\_for\\_Prevention\\_and\\_Elimination\\_of\\_WFCL\\_English\\_FINAL\\_\(2\).pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategy_for_Prevention_and_Elimination_of_WFCL_English_FINAL_(2).pdf)

<http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2016-17-shqip.pdf>

<http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/korniza-e-treguesve.pdf>

<http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2016-17.pdf>

### LITERATURA RELEVANTE

*Monitorimi i pjesëmarrjes në arsim: Korniza për monitorimin e fëmijëve dhe adoleshentëve që janë jashtë Shkollës ose në Rrezik të braktisjes së mësimi. UNICEF dhe ISU. Seritë e UNICEF-it për pjesëmarrjen në arsimin e obligueshëm dhe parandalimin e braktisjes së mësimi, Vol I. Gjenevë: Zyra rajonale e UNICEF për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura, 2016. Përfshirja sociale dhe arsimi gjithëpërfshirës. Marsela Robo. Academicus International Scientific Journal, 2014.*

*Anketë mbi arsimin gjithëpërfshirës në dhjetë shkolla fillore të Kosovës. Agoni-Destani, Hoxha, Kelmendi.*

KiE, 2015.

Publikimi i ECMI Kosovës mbi arsimin në gjuhën serbe në Kosovë, 2018.

<http://kosovotwopointzero.com/en/held-back-and-excluded/>



